

GALERIA KOMBËTARE E ARTEVE TIRANË

Në mbështetje të Vendimit Nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, shpall konkursin për pozicionin;

THIRRJE PËR APLIKIM SI KËSHILLTAR I JASHTËM PRANË DREJTORIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE

Profili: Këshilltar i Jashtëm për Zhvillim Institucional, Ndërveprim dhe Partneritete

KOHËZGJATJA

6 muaj

Galeria Kombëtare e Arteve, në kuadër të rihapjes, forcimit të kapaciteteve institucionale, zgjerimit të bashkëpunimit ndërinstitucional kombëtar, zhvillimit të projekteve strategjike dhe krijimit të partneriteteve të reja në funksion të misionit të saj, shpall thirrje të hapur për angazhimin e një Këshilltari të Jashtëm për Zhvillim Institucional, Ndërveprim dhe Partneritete, pranë Drejtorit të Galerisë Kombëtare të Arteve.

Angazhimi nuk mbivendoset me funksionet administrative, menaxheriale apo vendimmarrëse të strukturave dhe stafit të brendshëm të institucionit.

I. QËLLIMI I ANGAZHIMIT

Qëllimi i angazhimit është mbështetja e Drejtorit të Galerisë Kombëtare të Arteve në zhvillimin dhe konsolidimin institucional në fazën e rihapjes së institucionit, përmirësimin e organizimit dhe proceseve të brendshme, si dhe koordinimin e çështjeve me karakter administrativ dhe ndërinstitucional, në funksion të rritjes së eficiencës dhe realizimit të objektivave të institucionit.

Këshilltari do të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin e politikave dhe iniciativave strategjike, krijimin dhe forcimin e partneriteteve kombëtare, si dhe identifikimin e mundësive për

bashkëpunim dhe financim, duke mbështetur njëkohësisht zhvillimin dhe pozicionimin institucional të Galerisë.

II. DETYRAT E KËSHILLTARIT TË JASHTËM

Këshilltari i Jashtëm, në funksion të objektit të angazhimit, do të ketë këto detyra kryesore:

- Të mbështesë Drejtorin në zhvillimin dhe mirëfunksionimin institucional në fazën e rihapjes dhe ristrukturimin e Institucionit, përfshirë përmirësimin e strukturës organizative, proceseve të punës dhe koordinimit të brendshëm;
- Të kontribuojë në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator dhe procedural, si dhe në koordinimin e proceseve administrative, të prokurimit dhe kontraktimit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse;
- Të mbështesë koordinimin ndërinstitucional me ministrinë përgjegjëse, institucione të tjera publike dhe aktorë relevantë për realizimin e objektivave të Galerisë;
- Të kontribuojë në zhvillimin dhe forcimin e partneriteteve kombëtare, si dhe në bashkëpunimet dhe shkëmbimet me institucione homologe, organizata kulturore dhe partnerë strategjikë;
- Të mbështesë zhvillimin dhe formalizimin e bashkëpunimeve institucionale, përfshirë hartimin e marrëveshjeve, memorandumeve, projekt-propozimeve dhe dokumenteve strategjike;

Detyrat e mësipërme nuk përfshijnë funksione menaxheriale, administrative apo vendimmarrëse.

KUSHTET PËR KONKURIM DHE KRITERET E VEÇANTA:

Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon;

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për këtë pozicion;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si më poshtë:

Të ketë përfunduar arsimin e lartë universitar në nivelin Master Shkencor ose të barasvlershëm, në fushën e shkencave ekonomike, sociale, administrimit publik, menaxhimit, komunikimit, marrëdhënieve ndërkombëtare ose fusha të përafërta;

Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite përvojë profesionale, preferencialisht në administratën publike dhe/ose institucione publike;

Të ketë përvojë të dokumentuar në koordinimin dhe ndërveprimin ndërinstitucional, zhvillimin institucional, ndjekjen e proceseve administrative dhe bashkëpunimin me institucione të administratës publike;

Të ketë përvojë në hartimin, koordinimin, zbatimin ose monitorimin e projekteve dhe programeve, si dhe në përgatitjen e dokumenteve institucionale, analizave dhe raporteve;

Të ketë përvojë në projekte ose iniciativa në fushën e kulturës, artit dhe/ose industrive kreative, si dhe në bashkëpunimin me institucione, organizata ose aktorë të sektorit kulturor;

Përvoja në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian, organizata ndërkombëtare ose donatorë, si dhe njohja e mekanizmave të financimit dhe projekt-propozimeve, përbën avantazh;

Të ketë aftësi shumë të mira analitike, organizative, koordinuese dhe komunikuese, si dhe aftësi për të ndjekur paralelisht procese institucionale dhe projekte me aktorë të ndryshëm;

Të zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze; njohja e një gjuhe tjetër të Bashkimit Evropian përbën avantazh;

Të ketë njohuri të mira të funksionimit të administratës publike, proceseve institucionale dhe kuadrit procedural që lidhet me veprimtarinë e institucioneve publike.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 76 ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, ish godina e laboratorit të filmit “Albafilm”, Tiranë,

Shqipëri email: info@galeriakombetare.gov.al

- Jetëshkrimi i aplikantit;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- Fotokopje të diplomës;
- Fotokopje të listës së notave;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Çertifikata kualifikimi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë,

vlerësimet, pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, duhet bërë brenda datës 25.08.2026, nëpërmjet postës zyrtare, dorazi në Zyrën e Protokollit të Galerisë Kombëtare të Arteve, në adresën: Ruga “Aleksandër Moisiu”, Nr. 76, ish Kinostudio, godina “Albafilm”, Tiranë, Shqipëri apo me postë elektronike në adresën elektronike të Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë, info@galeriakombetare.gov.al

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Mosparaqitja e plotë e dokumenteve sjell s ‘kualifikim të kandidatit.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe intervista të drejtpërdrejta. Konkurimi do të zhvillohet në datë 26.08.2026 ora 10:00, në ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve, në adresën: Ruga “Aleksandër Moisiu”, Nr. 76 ish Kinostudio, godina “Albafilm”, Tiranë, Shqipëri.

VLERËSIMI I KANDIDATËVE

Vlerësimi i kandidatëve do të realizohet nga Galeria Kombëtare e Arteve, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje, eksperiencën profesionale dhe përshtatshmërinë e profilit të kandidatit me objektin e angazhimit.

Kandidatët që plotësojnë kriteret e kërkuara do të ftohen në intervistë.

SHPALLJA E REZULTATEVE

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen për rezultatet nëpërmjet adresës së e-mail-it të paraqitur në dokumentacionin e aplikimit.